



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KABINETI

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Përftimi i kontrollit të shoqërisë Opel Automotive S d.o.o. nga shoqëria Euroimpex d.o.o.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar shkresa Nr. 345 Prot., protokoll i AK, datë 25.09.2020 “Shkresë përcjellëse në lidhje me njoftimin për përqendrim të Euroimpex d.o.o.”, nëpërmjet të cilës është njoftuar transaksioni i përfimit të kontrollit të shoqërisë Opel Automotive S d.o.o. nga shoqëria Euroimpex d.o.o.

Palët kanë nënshkruar “Marrëveshjen e blerjes së aksioneve” më datë 04 shtator 2020.

Palët pjesëmarrëse:

Pala Blerëse: Euroimpex d.o.o., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Maqedonisë së Veriut. Euroimpex d.o.o. është shpërndarës i markës Peugeot kryesisht në territorin e Maqedonisë së Veriut dhe realizon të ardhura edhe në Shqipëri e Kosovë.

Pala Shitëse: Opel Southeast Europe LLC, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Hungarisë. Shitësi vepron si importues dhe shpërndarës i automjeteve Opel si dhe pjesëve të këmbimit, pajisjeve shtesë dhe aksesorëve për markat Opel dhe Chevrolet, në territorin e Evropës Juglindore. Shoqëria realizon të ardhura në Shqipëri.

Target: Opel Automotive S d.o.o. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas legjislacionit të Serbisë. Targeti është një ndërmarrje me qëllime të veçanta e themeluar dhe e zotëruar nga Opel Southeast Europe LLC, në vitin 2020 për qëllime të këtij transaksioni. Aktiviteti kryesor i Opel Automotive S d.o.o. do të jetë tregtimi i automjeteve dhe mjeteve motorike të lehta, shitje me pakicë e pjesëve të këmbimit dhe pajisjeve për mjete motorike etj. Targeti nuk ka filiale ose degë në Shqipëri.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.